



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:162417 C. nr. 2689/2023
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05732112

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditëses Z.P. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurit M. (A) S. nga Prizreni, për shkak vërtetimit pronësisë në bazë të trashëgimisë, jashtë seance, më datën 24 Maj 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja Z.P. ka paraqitur padi kundër të paditurit M.S. nga Prizreni, për vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë. Duke kërkuar të vërtetohet që është bashkëpronare në ngastrën kadastrale nr. 1795-0 ZK Prizren.

Gjithashtu e paditësja Zarife Pomak, ka paraqitur padinë tjetër kundër të paditurit M.S. e cila padi është regjistruar në numrin C. nr. 3712/2023, me të cilën gjithashtu ka kërkuar të vërtetohet se është bashkëpronare e ngastrës kadastrale nr. 1795-0 ZK Prizren.

Pasi që pala paditëse ka paraqitur dy padi kundër të njëjtit të paditur, ndërsa në lëndën C. nr. 3712/2023 gjykata ka filluar procedurën pasi që në atë lëndë pala paditëse ka propozuar caktimin e masë së sigurimit, ashtu që është krijuar gjyqvarësia, gjykata në kuptim të nenit 391 par.1 germa (c) e Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejuar kur konstaton se për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqvarësia.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr. 2689/2023 datë 24 Maj 2024

Gjyqtari,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë, në Gjykatën Apelit në Prishtinë, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.